



SQ Vatër gatimi

Udhëzimet për përdorim



PËRMBAJTJA

1. TË DHËNA PËR SIGURINË.....	2
2. UDHËZIMET PËR SIGURINË.....	4
3. PËRSHKRIM I PRODUKTIT.....	7
4. PËRDORIMI I PËRDITSHËM.....	8
5. UDHËZIME DHE KËSHILLA.....	9
6. KUJDESI DHE PASTRIMI.....	10
7. ZGJIDHJA E PROBLEMEVE.....	11
8. INSTALIMI.....	13
9. TË DHËNA TEKNIKE.....	15
10. EFIKASITETI ENERGJETIK.....	17

MENDOJMË PËR JU

Faleminderit që bletë pajisje Electrolux. Keni zgjedhur një produkt që sjell me vete dekada të tëra inovacioni dhe përvoja nga profesionistë. Ky produkt gjenial dhe elegant është projektuar duke ju pasur juve në mendje. Pra, sa herë që ta përdorni mund të ndiheni të sigurt do të merrni rezultate të shkëlqyera.

Mirë se vini në Electrolux.

Vizitoni faqen tonë të internetit për:



Marrjen e këshillave të përdorimit, broshurave, informacionit për zgjidhjen e problemeve dhe për shërbimin:

www.electrolux.com



Regjistrimin e produktit tuaj për shërbim më të mirë:

www.registerelectrolux.com



Blerjen e aksesorëve, pjesëve të konsumueshme dhe pjesëve origjinale të këmbimit për pajisjen tuaj:

www.electrolux.com/shop

KUJDESI DHE SHËRBIMI PËR KLIENTËT

Përdorni gjithmonë pjesë origjinale këmbimi.

Kur kontaktoni Qendrën tonë të Autorizuar të Shërbimit, sigurohuni që të dispononi të dhënat e mëposhtme: Modeli, PNC, numri serial.

Informacioni mund të gjendet në pllakën e specifikimeve.



Paralajmërim / Informacion për sigurinë/kujdesin



Informacion i përgjithshëm dhe këshilla



Informacion mjedisor

Rezervohet mundësia e ndryshimeve.

1. ⚠ TË DHËNA PËR SIGURINË

Përpara instalimit dhe përdorimit të pajisjes, lexoni me kujdes udhëzimet e ofruara. Prodhuesi nuk është përgjegjës nëse shkaktohen lëndime dhe dëme nga

instalimi dhe përdorimi i pasaktë. Gjithmonë mbajini udhëzimet bashkë me pajisjen, për t'iu referuar në të ardhmen.

1.1 Siguria e fëmijëve dhe personave me probleme

- Kjo pajisje mund të përdoret nga fëmijë të moshës 8 vjeç e sipër dhe persona me aftësi të kufizuara fizike, ndijimesh ose mendore ose që nuk kanë eksperiencë dhe njohuri, nëse këta mbahen nën mbikëqyrje ose udhëzohen për përdorimin e sigurt të pajisjes dhe i kuptojnë rreziqet e përdorimit.
- Mos lejoni fëmijët të luajnë me pajisjen.
- Mbajini të gjitha materialet e ambalazhimit larg fëmijëve.
- Mbajini fëmijët dhe kafshët shtëpiake larg pajisjes, gjatë kohës që ajo punon ose kur ftohet. Pjesët e arritshme janë të nxehta.
- Nëse pajisja ka një mekanizëm për sigurinë e fëmijëve, ne rekomandojmë që ta aktivizoni.
- Pastrimi dhe mirëmbajtja nuk duhet të kryhet nga fëmijët pa mbikëqyrje.
- Fëmijët më të vegjël se 3 vjeç duhet të mbahen larg, përveçse nëse mbikëqyren vazhdimisht.

1.2 Siguria e përgjithshme

- Pajisja dhe pjesët e saj të arritshme nxehen shumë gjatë përdorimit. Mos prekni elementet e nxehtë.
- Mos e përdorni pajisjen nëpërmjet një kohëmatësi të jashtëm ose një sistemi komandimi të veçantë.
- Mungesa e kontrollit të një gatimi me yndyrë ose vaj mbi një vatër mund të jetë e rrezikshme dhe mund të rezultojë në zjarr.
- Mos provoni kurrë që ta fikni zjarrin me ujë, por fikni pajisjen dhe pastaj mbulojeni flakën, p.sh. me një kapak ose me batanije kundër zjarrit.
- Mos vendosni sende mbi sipërfaqet e gatimit.

- Objektet metalike, të tilla si thikat, pirunët, lugët dhe kapakët nuk duhet të vendosen mbi sipërfaqen e vatrës, sepse mund të nxehen.
- Mos përdorni pastrues me avull për të pastruar pajisjen.
- Nëse sipërfaqja prej qeramike/xhami kriset, fiken pajisjen për të shmangur mundësinë e goditjes elektrike.
- Në rastin e thyerjes së vatrës prej xhami:
 - fikni menjëherë të gjitha vatrën dhe çdo element elektrik ngrohjeje dhe izolojeni pajisjen nga rryma elektrike,
 - mos e prekni sipërfaqen e pajisjes,
 - mos e përdorni pajisjen.
- Nëse kabloja ushqyese është e dëmtuar, ajo duhet zëvendësuar nga prodhuesi, agjenti i shërbimit ose persona të kualifikuar për të shmangur rreziqet.
- Aty ku pajisja lidhet drejtpërdrejt me korrentin, nevojitet një çelës izolues për të gjitha polet me një hapësirë kontakti. Duhet të garantohet shkëputja e plotë në përputhje me kushtet e specifikuara në kategorinë III të tensionit të tepërt. Kabloja e tokëzimit përjashtohet nga kjo.
- Kur të drejtoni kabllon e rrymës, sigurohuni që kabloja të mos ketë kontakt të drejtpërdrejtë (për shembull nëpërmjet veshjeve izoluese) me pjesët që mund të arrijnë temperatura prej 50°C mbi temperaturën e dhomës.

2. UDHËZIMET PËR SIGURINË

Kjo pajisje është e përshtatshme për tregjet e mëposhtme : **AL**

2.1 Instalimi



PARALAJMËRIM!

Vetëm një person i kualifikuar duhet ta instalojë këtë pajisje.

- Hiqni të gjithë paketimin
- Mos instaloni ose mos përdorni një pajisje të dëmtuar.
- Zbatoni udhëzimet e instalimit të dhëna me pajisjen.
- Ruani largësitë minimale nga pajisjet dhe njësitë e tjera.
- Gjithmonë bëni kujdes kur e lëvizni pajisjen sepse është e rëndë. Përdorni gjithnjë doreza sigurie.

- Mbyllini sipërfaqet e prera me një izolues për të mos lejuar që lagështira të shkaktojë fryrje.
- Mbroni pjesën e poshtme të pajisjes nga avulli dhe lagështira.
- Mos e instaloni pajisjen pranë dyerve ose nën dritare. Duke vepruar kështu do të parandaloni rënien e enëve të nxehta të gatimit nga pajisja kur hapet dera ose dritarja.
- Nëse pajisja instalohet mbi sirtarë sigurohuni që hapësira mes pjesës së poshtme të pajisjes dhe sirtarit të sipërm, të jetë e mjaftueshme për qarkullimin e ajrit
- Pjesa e poshtme e pajisjes mund të nxehtet. Sigurohuni që të instalohet një panel ndarës me material që nuk digjet poshtë pajisjes për të parandaluar arritjen e pjesës së poshtme.

2.2 Lidhja elektrike



PARALAJMËRIM!

Rrezik zjarri dhe goditje elektrike.

- Të gjitha lidhjet elektrike duhen kryer nga një elektrikist i kualifikuar.
- Pajisja duhet tokëzuar.
- Përpara se të kryeni ndonjë veprim, sigurohuni që pajisja të jetë shkëputur nga rryma.
- Sigurohuni që të dhënat elektrike në pllakën e specifikimeve të përkojnë me karakteristikat e rrejtës elektrik. Nëse nuk përkojnë, kontakti me një elektrikist.
- Sigurohuni që pajisja të instalohet saktë. Kabloja ose spina e lirë ose e papërshtatshme elektrike (nëse ka) mund ta nxehtë shumë terminalin.
- Përdorni kablo elektrike të përshtatshme.
- Mos i lini kabllot elektrike të përdridhen.
- Sigurohuni që të jetë instaluar mbrojtja ndaj goditjeve elektrike.
- Përdorni mbërthyesen e lirimit të tensionit të kablos.
- Sigurohuni që kabloja ose spina elektrike (nëse ka) të mos prekë pajisjen e nxehtë ose enët e nxehta të

gatimit, kur e lidhni pajisjen me prizat që gjenden pranë

- Mos përdorni përshtatës me shumë spina dhe kabëll zgjatues.
- Sigurohuni që të mos dëmtoni spinën elektrike (nëse ka) ose kabllon elektrike. Kontakti me qendrën e autorizuar të shërbimit ose me një elektrikist për ndërrimin e kablos elektrike të dëmtuar.
- Mbrojtja nga goditja e pjesëve me korrent dhe të izoluar duhet të shtrëngohet në mënyrë të tillë që të mos hiqet pa vegla.
- Pajisjen futeni në prizë vetëm në fund të instalimit. Sigurohuni që spina të jetë e arritshme pas montimit të pajisjes.
- Nëse priza është e lirë, mos e futni spinën.
- Mos e shkëputni pajisjen nga rrjeti duke e tërhequr nga kabli elektrik. Gjithmonë tërhiqeni kabllin duke e kapur nga spina.
- Përdorni mjetet e duhura izoluese: çelësa mbrojtës të linjës, siguresa (siguresa tip vidë të hequra nga mbajtësja), çelësa të humbjeve në neutral dhe kontaktorë.
- Instalimi elektrik duhet të ketë një pajisje instaluese e cila ju lejon të shkëpusni pajisjen nga rryma elektrike në të gjitha polet. Pajisja instaluese duhet të ketë një hapje kontakti me gjerësi minimale 3 mm.

2.3 Lidhja me gazin

- Të gjitha lidhjet e gazit duhen kryer nga një person i kualifikuar.
- Para instalimit, sigurohuni që kushtet e furnizimit lokal (lloji i gazit dhe presioni i gazit) dhe përshtatja e pajisjes të jenë të përputhshme.
- Sigurohuni që rreth pajisjes të qarkullojë ajër.
- Informacioni mbi furnizimin me gaz ndodhet në pllakën e specifikimeve.
- Kjo pajisje nuk është lidhur me një pajisje që nxjerr tymrat e djegies. Sigurohuni që të lidhni pajisjen sipas rregullores ekzistuese për instalimin. Kushtojini vëmendje kërkesave në lidhje me ajrosjen e mjaftueshme.

2.4 Përdorimi



PARALAJMËRIM!

Rrezik lëndimi, djegiesh dhe goditjeje elektrike.

- Hiqni të gjithë paketimin, etiketat dhe veshjen mbrojtëse (nëse ka) përpara përdorimit për herë të parë.
- Përdorni pajisjen në mjedis shtëpiak.
- Mos i ndryshoni specifikimet e kësaj pajisjeje.
- Sigurohuni që vrimat e ajrimit të mos bllokohen.
- Mos e lini pajisjen të pambikëqyrur gjatë punës.
- Fikini zonat e gatimit pas çdo përdorimi.
- Mos vendosni takëme ose kapakë tenxheresh mbi zonat e gatimit. Ato mund të nxehen.
- Mos e përdorni pajisjen me duar të lagura ose kur ajo ka kontakt me ujin.
- Mos e përdorni pajisjen si sipërfaqe pune ose për të mbajtur sende.
- Nëse sipërfaqja e pajisjes kriset, shkëputeni menjëherë pajisjen nga rrjeti elektrik. Kjo bëhet për të parandaluar goditjet elektrike.
- Kur e vendosni ushqimin në vaj të nxehtë, ai mund të spërkasë.



PARALAJMËRIM!

Rrezik zjarri dhe shpërthimi

- Yndyrat dhe vajrat kur nxehen mund të lëshojnë avuj të ndezshëm. Mbajeni flakën ose objektet e nxehta larg nga yndyrat dhe vajrat kur gatuar me to.
- Avujt që lëshon vaji shumë i nxehtë mund të shkaktojnë ndezje spontane.
- Vaji i përdorur që përmban mbetje ushqimore, mund të shkaktojë zjarr në temperaturë më të ulët sesa vaji që përdoret për herë të parë.
- Mos vendosni produkte të ndezshme ose sende të lagura me produkte të ndezshme brenda, pranë ose mbi pajisjeje.



PARALAJMËRIM!

Rrezik dëmtimi i pajisjes.

- Mos mbani enë të nxehta mbi panelin e kontrollit.

- Mos vini enë bosh mbi vatrën e nxehtë.
- Bëni kujdes të mos lini objekte ose enë gatimi të bien mbi pajisje. Sipërfaqja mund të dëmtohet.
- Mos i aktivizoni zonat e gatimit me enë të zbrazëta ose pa enë gatimi.
- Mos vendosni letër alumini mbi pajisjeje.
- Enët e gatimit prej gize, alumini ose enët me fund të dëmtuar mund ta gërvishin xhamin/qeramikën prej xhami. Gjithmonë ngrijini këto objekte kur duhet t'i vendosni në sipërfaqen e gatimit.
- Përdorni vetëm enë gatimi të qëndrueshme me formën e duhur dhe me diametër më të madh se dimensionet e vatrave.
- Sigurohuni që enët e gatimit të vendosen në qendër të vatrave.
- Sigurohuni që flaka të mos fiket kur e rrotulloni çelësin shpejt nga pozicioni maksimal në atë minimal.
- Përdorni vetëm aksesorët e ofruar me pajisjen.
- Mos instaloni një difuzor flake mbi vatrë.
- Përdorimi i pajisjes së gatimit me gaz gjeneron nxehtësi dhe lagështi. Dhoma ku instalohet pajisja duhet të ketë ajrosje të mirë.
- Përdorimi intensiv dhe për një kohë të gjatë i pajisjes mund të sjellë nevojën për më shumë ajrim, si për shembull për të hapur një dritare ose për një ajrim më efikas, siç mund të jetë rritja e nivelit të ajrimit mekanik nëse është e mundur.
- Kjo pajisje është vetëm për përdorime gatimi. Ajo nuk duhet të përdoret për funksione të tjera, për shembull për ngrohje dhome.
- Mos lejoni që lëngje acide të tilla si uthulla, lëngu i limonit ose kimikate për heqjen e bigorrit të prekin vatrën. Kjo mund të shkaktojë njolla pa shkëlqim.

2.5 Kujdesi dhe pastrimi

- Pastrojeni pajisjen rregullisht për të parandaluar dëmtimin e materialit të sipërfaqes.

- Çaktivizojeni pajisjen dhe lëreni të ftohet para se ta pastroni.
- Përpara mirëmbajtjes, shkëputeni pajisjen nga energjia elektrike.
- Mos përdorni ujë me spërkatje dhe avull për të pastruar pajisjen.
- Pastrojeni pajisjen me një leckë të butë dhe të lagësht. Përdorni vetëm detergjente neutrale. Mos përdorni produkte gërryese, materiale pastruese të ashpra, tretës ose objekte metalike.
- Mos i pastroni vatrat në enëlarëse.

2.6 Hedhja e mbeturinave




PARALAJMËRIM!

Rrezik lëndimi ose mbytjeje.

3. PËRSHKRIM I PRODUKTIT

3.1 Hapësira e sipërfaqes së gatimit



- 1** Treguesi i nxehtësisë së mbetur
- 2** Vatra e shpejtë
- 3** Zona elektrike e gatimit
- 4** Vatra gjysmë e shpejtë
- 5** Vatra ndihmëse
- 6** Çelësat e kontrollit

3.2 Çelësi i kontrollit

Simboli	Përshkrimi
	nuk ka furnizim me gaz / pozicioni fikur
	pozicioni i ndezjes / furnizim maksimal me gaz
	furnizim minimal me gaz

3.3 Përzgjedhja e nxehtësisë

Simbolet	Funksioni
0	Pozicioni fikur
1 - 6	Cilësimet e ngrohjes

- Kontaktoni autoritetin e bashkisë suaj për t'u informuar mbi mënyrën e duhur të hedhjes së pajisjes.
- Shkëputeni pajisjen nga rrjeti i furnizimit me energji.
- Prisni kabllon e lidhjes me rrjetin dhe hidheni atë.
- Shtypni tubat e jashtëm të gazit.

2.7 Shërbimi

- Për të riparuar pajisjen kontaktoni me një qendër të autorizuar shërbimi.
- Përdorni vetëm pjesë këmbimi origjinale.



Përdorni ngrohtësinë e mbetur për të ulur konsumin e energjisë. Çaktivizojeni zonën e gatimit për 5 - 10 minuta përpara se të ketë përfunduar procesi i gatimit.

Rrotulloni çelësin deri te cilësimi i dëshiruar i nxehjes.

Për të përfunduar procesin e gatimit, rrotullojeni çelësin në pozicionin e fikjes.


4. PËRDORIMI I PËRDITSHËM



PARALAJMËRIM!

Drejtojuni kapitujve për sigurinë.

4.1 Pamje e përgjithshme e vatrës së gatimit



- A) Kapaku dhe kurora e vatrës
- B) Termoçifti
- C) Kandela e ndezjes

4.2 Ndezja e vatrës



Ndizni gjithnjë vatrën përpara se të vendosni enët mbi të.



PARALAJMËRIM!

Bëni shumë kujdes kur përdorni zjarr të hapur në mjedisin e kuzhinës. Prodhuesi nuk mban asnjë përgjegjësi në rast se flaka keqpërdoret.

1. Shtypni çelësin e kontrollit dhe rrotullojeni në drejtim kundërorar drejt

pozicionit të furnizimit maksimal me gaz (↑).

2. Mbajeni çelësin e kontrollit të shtypur për 10 sekonda ose më pak. Kjo mundëson ngrohjen e termoçiftit. Në të kundërt, furnizimi me gaz ndërpritet.
3. Rregullojeni flakën pasi të ndizet normalisht.



Nëse pas disa përpjekjesh vatra nuk ndizet, kontrolloni nëse kurora dhe kapaku i saj janë vendosur në pozicionin e duhur.



PARALAJMËRIM!

Mos e mbani çelësin e kontrollit të shtypur për më shumë se 15 sekonda. Nëse vatra nuk ndizet pas 15 sekondash, lëshoni çelësin e kontrollit, rrotullojeni në pozicionin fikur dhe prisni të paktën 1 minutë përpara se të provoni ta rindizni vatrën.



KUJDES!

Në mungesë të energjisë elektrike mund ta ndizni vatrën pa ndihmën e ndezësit elektrik; në këtë rast afroni një flakë te vatra, rrotulloni çelësin e kontrollit në drejtim kundërorar drejt pozicionit të furnizimit maksimal me gaz dhe shtypeni. Mbajeni çelësin e kontrollit të shtypur për 10 sekonda ose më pak për të mundësuar ngrohjen e termoçiftit.

 Nëse vatra fiket aksidentalisht, rrotullojeni çelësin e kontrollit në pozicionin fikur dhe provoni ta rindizni vatrën pas të paktën 1 minute.

 Gjeneratori i shkëndijave mund të ndizet automatikisht kur e lidhni me rrjetin elektrik, pas instalimit ose pas ndërprerjes së energjisë. Kjo është normale.

4.3 Fikja e vatrës

Për të fikur flakën, rrotullojeni çelësin në pozicionin e fikjes ●.

 **PARALAJMËRIM!**
Gjithnjë uleni flakën ose fiken atë përpara se të hiqni enët nga vatra.

4.4 Përpara përdorimit të parë

Vendosni një enë gatimi me ujë mbi secilën nga zonat elektrike të gatimit,

caktoni pozicionin maksimal dhe lëreni vatrën të punojë për 10 minuta. Kjo bëhet për të djegur mbetjet në pajisje. Pas kësaj, lëreni vatrën të punojë në pozicionin minimal për 20 minuta. Gjatë kësaj periudhe mund të dalë aromë e pakëndshme dhe tym. Kjo është normale. Sigurohuni që qarkullimi i ajrit të jetë i mjaftueshëm.

4.5 Shembuj të gatimeve

Cilësi- Përdorimi: mi i nxeh- tësisë:	
1	Për të mbajtur ngrohtë
2	Për një valë të lehtë
3	Për të zier pak
4	Për skuqje / karamelizim
5	Për vlim
6	Për vlim / skuqje të shpejtë / skuqje të thellë

5. UDHËZIME DHE KËSHILLA

 **PARALAJMËRIM!**
Drejtouni kaputujve për sigurinë.

5.1 Enët e gatimit

Elektrike:

 Fundi i enëve të gatimit duhet të jetë sa më i trashë dhe më i rrafshët që të jetë e mundur.

 Enët prej çeliku të emaluar dhe me bazamente alumini ose bakri mund të shkaktojnë çngjyrosje mbi sipërfaqen prej qeramike xhami.

 **KUJDES!**
Mos përdorni tiganë prej gize, enë argjile, enë balte, pllaka skare ose pllakat thekëse.

Gaz:

 **PARALAJMËRIM!**
Mos vendosni të njëjtin tigan mbi dy vatra.

 **PARALAJMËRIM!**
Mos vendosni mbi vatër tenxhere që nuk qëndrojnë mirë ose janë të dëmtuara për të parandaluar derdhjen dhe lëndimet.

**KUJDES!**

Sigurohuni që fundet e tenxhereve të mos qëndrojnë mbi çelësin e kontrollit, ndryshe flaka nxeh çelësin e kontrollit.

**KUJDES!**

Sigurohuni që dorezat e tenxhereve të mos qëndrojnë mbi pjesën e përparme të sipërfaqes së vatrës.

**KUJDES!**

Sigurohuni që tenxheret të jenë vendosur në qendër mbi vatër, për të përfutur stabilitet maksimal dhe konsumin më të ulët të gazit.

**KUJDES!**

Lëngjet e derdhura gjatë gatimit mund të shkaktojnë thyerjen e xhamit.

5.2 Diametrat e enëve të gatimit



Përdorni enë gatimi, diametri i të cilave korrespondon me përmasat e vatrave.

Vatra	Diametri i enës së gatimit (mm)
Rapid (E shpejtë)	160 - 260
Gjysmë e shpejtë	120 - 220
Ndihmëse	80 - 160

6. KUJDESI DHE PASTRIMI

**PARALAJMËRIM!**

Drejtojuni kapitujve për sigurinë.

6.1 Informacione të përgjithshme

- Pastroni vatrën pas çdo përdorimi.
- Përdorni gjithmonë enë me bazament të pastër.
- Gërvishtjet ose njollat e errëta mbi sipërfaqe nuk ndikojnë në funksionimin e vatrës.
- Përdorni një pastrues të veçantë që mund të përdoret për sipërfaqen e vatrës.
- Përdorni kruajtëse të posaçme për xhamin.

**PARALAJMËRIM!**

Mos përdorni thikë, kruajtëse ose instrumente të ngjashme për të pastruar sipërfaqen e xhamit ose vendet midis buzëve të vatrave dhe skeletit (nëse ka).

- Lani pjesët prej inoksi me ujë dhe pastaj thajini me një leckë të butë.

6.2 Skarat mbështetëse të tenxhereve



Skarat e enëve nuk janë rezistente ndaj larjes në enëlarëse. Ato duhet të lahen me dorë.

1. Për ta pastruar më mirë vatrën, hiqni skarat mbështetëse të tenxhereve.
2. Tregoni shumë kujdes kur t'i rivendosni skarat mbështetëse, për të mos e dëmtuar rrafshin e gatimit.
3. Veshja prej smalti ndonjëherë mund të ketë cepa të fortë, kështu që bëni kujdes kur të lani me dorë mbështetëset e tiganëve dhe kur t'u thani. Nëse është e nevojshme, hiqni njollat e forta me një pastrues në trajtë paste.
3. Pas pastrimit të skarave mbështetëse të tenxhereve, sigurohuni që ato të vendosen në pozicionin e duhur.
4. Në mënyrë që vatra të funksionojë mirë, sigurohuni që skarat mbështetëse të tenxhereve të jenë në qendër të vatrës.

6.3 Pastrimi i vatrës

- **Hiqni menjëherë:** plastmasë të shkrirë, celofan dhe ushqime me sheqer. Nëse nuk e bëni, vatra mund të dëmtohet nga papastërtia. Vendoseni kruajtësen speciale mbi sipërfaqen e xhamit në një kënd të ngushtë dhe rrëshqiteni tehu mbi sipërfaqe.
- **Hiqeni kur vatra të jetë ftohur mjaftueshëm:** njollat e çmërsit, rrëketë e ujit, njollat e yndyrës, çngjyrosjet e ndritshme metalike. Pastrojeni vatrën me një leckë të njomë dhe me pak detergjent. Pas pastrimit, thajeni vatrën me një leckë të butë.
- Për t'i pastruar pjesët e emaluara, bekun dhe kurorën, lajini ato me ujë të ngrohtë dhe sapun dhe thajini me

kujdes përpara se t'i vendosni në vend.

6.4 Pastrimi i kandelës së ndezjes

Kjo karakteristikë realizohet nëpërmjet një kandle ndezëse prej qeramike me një elektrodë metalike. Këta elementë mbajini të pastra për të shmangur vështirësitë në ndezje, si dhe kontrolloni që vrimat e kurorës së vatrës të mos jenë të bllokuara.

6.5 Mirëmbajtja periodike

Flisni vazhdimisht me qendrën tuaj lokale të autorizuar të shërbimit që të kontrollojnë gjendjen e tubit të gazit dhe rregulluesin e presionit, nëse është i pranishëm.

7. ZGJIDHJA E PROBLEMEVE



PARALAJMËRIM!

Drejtojuuni kapitujve për sigurinë.

7.1 Si të veprojmë nëse...

Problemi	Shkaku i mundshëm	Zgjidhja
Nuk arrini ta aktivizoni ose ta vini në punë pianurën.	Pianura nuk është e lidhur me rrjetin elektrik ose nuk është lidhur saktë.	Kontrolloni nëse pianura është lidhur siç duhet me rrjetin elektrik. Referojuni qarkut të lidhjes.
	Ka rënë siguresa.	Sigurohuni që shkaku i mosfunksionimit është siguresa. Nëse siguresa lirohet vazhdimisht, kontaktoni një elektrikist të kualifikuar.
Nuk ka shkëndijë kur mundoheni të aktivizoni ndezësin e shkëndijës.	Pianura nuk është e lidhur me rrjetin elektrik ose nuk është lidhur saktë.	Kontrolloni nëse pianura është lidhur siç duhet me rrjetin elektrik.
	Ka rënë siguresa.	Sigurohuni që shkaku i mosfunksionimit është siguresa. Nëse siguresa lirohet vazhdimisht, kontaktoni një elektrikist të kualifikuar.

Problemi	Shkaku i mundshëm	Zgjidhja
	Kapaku dhe kurora e gati-mit janë vendosur të pani-veluara.	Vendoseni mirë kapakun dhe kurorën e vatrës.
Flaka fiket menjëherë pas ndezjes.	Termoçifti nuk është nxe-hur sa duhet.	Pasi të keni ndezur flakën, mbajeni çelësin të shtypur për 10 ose më pak sekonda.
Unaza e flakës nuk është e niveluar.	Kurora e vatrës është e bllokuar nga mbetjet ushqimore.	Sigurohuni që injektori të mos jetë bllokuar si dhe që kurora e vatrës të jetë e pastër.


7.2 Nëse nuk mund të gjeni zgjidhje...

Nëse nuk e gjeni dot vetë një zgjidhje, kontakti shitësin tuaj ose me një qendër shërbimi të autorizuar. Jepni të dhënat nga pllaka e specifikimeve. Jepni gjithashtu mesazhin e defektit që ndizet. Sigurohuni që pianurën ta keni përdorur saktë. Nëse jo, servisi nga tekniku i shërbimit apo shitësi nuk do të

jetë falas, edhe gjatë periudhës së garancisë. Udhëzimet lidhur me qendrën e shërbimit dhe kushtet e garancisë janë në broshurën e garancisë.

7.3 Etiketat që merren me çantën e aksesoreve

Ngjisni etiketat adezive siç tregohet më poshtë:



- A) Ngjitni mbi letrën e garancisë dhe dërgoni këtë pjesë (nëse zbatohet).
 B) Ngjitni mbi letrën e garancisë dhe mbajeni këtë pjesë (nëse zbatohet).

- C) Ngjitni mbi librin e udhëzimeve.

8. INSTALIMI



PARALAJMËRIM!

Drejttojuni kapitujve për sigurinë.

8.1 Përpara instalimit

Përpara se të instaloni vatrën, shkruani informacionin e mëposhtëm nga pllaka e specifikimeve. Pllaka e specifikimeve gjendet në pjesën e poshtme të vatrës.

Modeli
PNC
Numri i serisë

8.2 Lidhja e gazit




PARALAJMËRIM!

Udhëzimet e mëposhtme rreth instalimit, lidhjes dhe mirëmbajtjes duhet të kryhen nga personel i kualifikuar dhe në përputhje me standardet dhe rregulloret vendore në fuqi.

Zgjidhni lidhje të palëvizshme ose përdorni një tub fleksibël prej inoksi në përputhje me rregulloren në fuqi. Nëse përdorni tuba metalikë fleksibël, bëni kujdes që ata të mos bien në kontakt me pjesët e lëvizshme ose që të mos shtypen. Gjithashtu, kini kujdes kur pianura vendoset bashkë me furrën.



Sigurohuni që presioni i furnizimit me gaz të pajisjes përputhet me vlerat e rekomanduara. Lidhja e rregullueshme fiksohet në pjerrësinë e zakonshme nëpërmjet një dadoje të filetuar G 1/2". Vidhosini pjesët pa ushtruar forcë, rregullojeni lidhjen në drejtimin e duhur dhe shtrëngoni çdo gjë.



A) Fundi i boshtit me dado

B) Rondela

C) Bërryli (nëse nevojitet)

Gaz i lëngshëm

Përdorni mbajtësen prej gome të tubit për gazin e lëngshëm. Përdorni gjithmonë guarnicionin. Më pas vazhdoni me lidhjen e gazit.

Tubi fleksibël është gati për t'u përdorur kur:

- nuk nxehet më shumë se temperatura e ambientit ose më shumë se 30°C;
- nuk është më i gjatë se 1500 mm;
- nuk ka ngushtime;
- nuk është tërhequr ose përdredhur;
- nuk është në kontakt me pjesë të mprehta ose qoshe;
- mund të kontrollohet lehtësisht për t'u siguruar për gjendjen e tij.

Kontrolli për ruajtjen e tubit fleksibël konsiston në verifikimin që:

- ai nuk ka plasaritje, prerje, shenja djegieje në të dyja skajet dhe në të gjithë gjatësinë e tij;
- materiali përbërës nuk është forcuar, por ka elasticitetin e duhur;
- morsetat shtrënguese nuk janë ndryshkur;
- afati i skadimit nuk ka kaluar.

Nëse vihet re një ose më shumë anomali, mos e riparoni tubin, por thjesht zëvendësojeni.



PARALAJMËRIM!

Kur të ketë përfunduar instalimi, sigurohuni që guarnicioni i secilës lidhje të jetë i saktë. Përdorni një solucion me sapun, jo flakë!

8.3 Zëvendësimi i injektorëve


1. Hiqni skarat mbështetëse të tenxhereve.
2. Hiqni kapakët dhe kurorat e vatrës.
3. Hiqni injektorët me një çelës 7 dhe zëvendësojini me ato që nevojiten për llojin e gazit që përdorni (shikoni tabelën në kapitullin "Të dhënat teknike").
4. Rimontoni pjesët, duke ndjekur të njëjtat hapa në rend të kundërt.
5. Zëvendësoni etiketën e specifikimeve (që është vendosur pranë tubit të furnizimit me gaz) me një tjetër të përshtatshme për llojin e gazit. Mund ta gjeni këtë etiketë në ambalazhin që keni marrë bashkë me pajisjen.

Nëse presioni i furnizimit me gaz është i ndryshueshëm ose i ndryshëm nga presioni i nevojshëm, duhet të instaloni një pajisje rregulluese të presionit të tubi i furnizimit me gaz.

8.4 Rregullimi i nivelit minimal

Për të rregulluar nivelin minimal të vatrave:

1. Ndizni vatrën.
2. Rrotulloni çelësin në pozicionin minimal.
3. Hiqni dorezën.
4. Me një kaçavidë të hollë, rregulloni pozicionin e vidës anashkaluese (A).



5. Nëse ndryshoni:
 - Nëse ndryshoni nga gazi natyror G20 20 mbar në gaz të lëngët, shtrëngoni plotësisht vidën anashkaluese deri në fund.
 - Nëse kaloni nga gazi i lëngshëm në gaz natyror G20 20 mbar, zhvidhoseni vidën anashkaluese me rreth 1/4 rrotullim.



PARALAJMËRIMI

Sigurohuni që flaka të mos fiket kur e rrotulloni çelësin shpejt nga pozicioni maksimal në atë minimal.

8.5 Lidhja elektrike

- Sigurohuni që vlerat e tensionit dhe lloji i fuqisë në pllakën e specifikimeve të përkojnë me tensionin dhe fuqinë e rrjetit tuaj elektrik lokal.
- Kjo pajisje është e pajisur me një kablo elektrike. Ajo duhet të pajiset me spinën e duhur, e cila përballon ngarkesën e shënuar në etiketën e specifikimeve. Sigurohuni që të instaloni spinën në një prizë të saktë.
- Përdorni gjithmonë një prizë me tokëzim të instaluar mirë.
- Sigurohuni që spina të jetë e arritshme pas instalimit.
- Mos e shkëputni pajisjen nga rrjeti duke e tërhequr nga kabli elektrik. Gjithmonë tërhiqeni kablun duke e kapur nga spina.
- Ka rrezik zjarri kur pajisja lidhet me kablo zgjatuese, adaptor ose lidhje të shumëfishta. Sigurohuni që tokëzimi të jetë në përputhje me standardet dhe rregulloret.
- Mos lejoni që kabloja e rrymës të nxehtet në një temperaturë më të lartë se 90°C.



Sigurohuni që të lidhni telin blu të nudit me terminalin e shënuar me germën "N". Lidhni telin kaf (ose të zi) të fazës me terminalin e shënuar me germën "L". Mbajeni telin e fazës të lidhur në çdo kohë.




8.6 Kabloja e lidhjes

Për ta ndërruar kabllo bashkuese, përdorni vetëm kablo speciale ose ekuivalente të saj. Lloji i kabllos është: H05V2V2-F T90.

Sigurohuni që seksioni i kabllos të jetë i përshtatshëm për tensionin dhe temperaturën e punës. Teli i tokëzimit me ngjyrë të verdhë/jeshile duhet të jetë

afërsisht 2 cm më i gjatë se teli i fazës kaf (ose i zi).

8.7 Montimi



A) guarnicioni i dhënë

B) kllapat e dhëna




KUJDES!

Pajisjen instalojeni vetëm në një bango të sheshtë.

8.8 Mundësitë e montimit në mobilie

Paneli i instaluar nën pianurë duhet të jetë lehtësisht i lëvizshëm dhe të mundësojë ndërhyrjet teknike me lehtësi në rast nevojë.

Njësi kuzhine me derë



A) Paneli i çmontueshëm

B) Hapësira për lidhjet

Njësi kuzhine me furrë

Lidhja elektrike e pianurës dhe ajo e furrës duhen instaluar veçmas për arsye sigurie dhe për ta lëvizur me lehtësi furrën nga njësia.

9. TË DHËNA TEKNIKE

9.1 Përmasat e vatrës së gatimit

Gjerësia	580 mm
Thellësia	510 mm

9.2 Diametrat e shuntit

VATRA	Ø SHUNTI 1/100 mm
E shpejtë	52

VATRA	Ø SHUNTI 1/100 mm
Gjysmë e shpejtë	32
Ndihmëse	28

9.3 Të dhëna teknike të tjera

FUQIA TOTALE:	Gaz original:	G20 (2H) 20 mbar = 5,6 kW
	Zëvendësimi i gazit:	G30/G31 (3B/P) 30/30 mbar = 407 g/h
	Zonat elektrike:	1,8 kW
Furnizimi elektrik:	220-240 V ~ 50/60 Hz	
Kategoria e pajisjes:	II2H3B/P	
Lidhja e gazit:	G 1/2"	
Kategoria e pajisjes:	3	

9.4 Vatra gazi vetëm për GAZ NATYROR G20 20 mbar

VATRA	FUQIA NORMALE kW	FUQIA MINIMALE kW	SHENJA E INJEKTORIT 1/100 mm
E shpejtë	2,7	0,75	130
Gjysmë e shpejtë	1,9	0,45	96
Ndihmëse	1,0	0,33	70

9.5 Vatra gazi për LPG G30/G31 30/30 mbar

VATRA	FUQIA NORMALE kW	FUQIA MINIMALE kW	SHENJA E INJEKTORIT 1/100 mm	QARKULLIMI NOMINAL I GAZIT në g/h
E shpejtë	2,7	0,75	86	196
Gjysmë e shpejtë	1,9	0,45	71	138
Ndihmëse	1,0	0,33	50	73

9.6 Specifikimi i zonave elektrike të gatimit

Zona e gatimit	Fuqia nominale (Cilësimi i nxehëtisë maksimale) [W]	Diametri i zonës së gatimit [mm]
Majtas, e pasme	1800	180

Për rezultate optimale gatimi, përdorni enë gatimi me diametër jo më të madh se zona e gatimit.

10. EFIKASITETI ENERGJETIK

10.1 Informacioni i produktit sipas EU 66/2014

Identifikimi i modelit		EGE6182NOK
Lloji i pianurës		Pianura inkaso
Numri i zonave elektrike të gatimit		1
Teknologjia e ngrohjes për secilën zonë elektrike gatimi		Radiator
Diametri i zonave rrethore elektrike të gatimit (Ø)	Prapa majtas	18,0 cm
Konsumi i energjisë për zonë gatimi (EC electric cooking)	Prapa majtas	180,2 Wh/kg
Numri i vatrave të gazit		3
Efikasiteti energjetik për vatër gazi (EE gas burner)	Prapa djathtas - Gjysmë e shpejtë	61.9%
	Përpara majtas - E shpejtë	58.2%
	Përpara djathtas - Ndihm-ëse	nuk disponohet
Efikasiteti energjetik për vatrën e gazit (EE gas hob)		60.7%
Konsumi i energjisë i pianurës (EC electric hob)		180,2 Wh/kg

EN 30-2-1: Pajisjet shtëpiake të gatimit që djegin gaz - Pjesa 2-1 : Përdorimi racional i energjisë - Të përgjithshme

EN 60350-2 - Pajisje shtëpiake gatimi me energji elektrike - Pjesa 2: Pianurat - Metodat e matjes së performancës

10.2 Kursimi i energjisë

Mund të kurseni energji gjatë gatimit të përditshëm nëse ndiqni këshillat në vijim.

- Kur ngrohni ujë, përdorni vetëm sasinë që ju nevojitet.
- Nëse është e mundur, vendosni gjithmonë kapakët mbi enët e gatimit.
- Vendosni enët e gatimit në zonën e gatimit përpara se ta aktivizoni.
- Fundi i enës së gatimit duhet të ketë të njëjtin diametër me zonën e gatimit.

- Enët më të vogla vendosini në zonat më të vogla të gatimit.
- Vendosini enët direkt në qendër të zonës së gatimit.
- Përdorni nxehtësinë e mbetur për ta mbajtur ushqimin ngrohtë ose për ta shkrirë atë.
- Përpara përdorimit të vatrave të gazit dhe skarave mbështetëse, sigurohuni që janë montuar siç duhet.

- Fundet e enëve të gatimit duhet të kenë diametrat e duhur për madhësinë e vatrës.
- Vendoseni enën e gatimit menjëherë mbi vatër dhe në qendër të saj.
- Kur lëngu fillon të vlojë, uleni flakën sa për të zier pak ujin.
- Nëse është e mundur, përdorni tenxhere me presion. Referojuni manualit të saj të përdorimit.

11. ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AMBIENTIN

Ricikloni materialet me simbolin . Vendoseni ambalazhin te kontejnerët e riciklimit nëse ka. Ndhmoni në mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njerëzve dhe në riciklimin e mbetjeve të pajisjeve elektrike dhe elektronike. Mos hidhni

pajisjet e shënuara me simbolin  e mbeturinave shtëpiake. Ktheni produktin në pikën lokale të riciklimit ose kontaktoni me zyrën komunale.

www.electrolux.com/shop



867321672-A-242015

